



*Jeni në fillim të karrierës por ju duhet ende eksperiencë për të gjetur punën e ëndrrave?*

*Keni punuar shumë dhe ndërkohë që po përfundoni shkollën ju duhet ende eksperiencë?*

*Dëshironi të angazhoheni në aktivitete interesante për të zhvilluar kapacitetet profesionale dhe personale?*

**A mendon se kjo Botë ka nevojë për disa ndryshime?**

**Atëherë trajnimi ynë imp!akt Tirana është për JU**

**Zhvillo një projekt dhe gjej një ekip!**

## **Çfarë është trajnimi imp!act Tirana?**

*Imp!act Tirana është një trajnim prej 3.5 ditësh që mbledh të rinj entuziastë që duan të ndryshojnë Botën në të cilën jetojnë por i mungojnë njohuritë praktike, rrjeti dhe/ose besimi për të filluar. Prandaj, imp!act Tirana i çon pjesëmarrësit në çdo fazë të nevojshme dhe i pajis ata me të gjitha mjetet e duhura për të lançuar një projekt-ide. Në ditën e fundit, pjesëmarrësit e rinj do të kenë shansin unik për të kërkuar këshilla dhe të marrin një vlerësim konstruktiv nga profesionistë të vërtetë.*

## **Çfarë do të ndodh në IMP!ACT TIRANA?**

### **DITA 1 – GJENI FRYMËZIMIN**

**Njihuni me "Ndryshuesit", dmth të rinj të cilët kanë gjetur një mënyrë për të luftuar sfidat globale në Tiranë, ose kanë filluar projektet e tyre. Më pas, ju tashmë keni filluar diskutimin dhe shkëmbimin e ideve me të gjithë pjesëmarrësit e tjerë.**

### **DITA 2 – ÇLIRONI KREATIVITETIN TUAJ**

**Sillni interesat tuaja, pasionet, anët e forta dhe transformojini ato një në projekt ide. Përzgjidhni idetë tuaja të reja, gjeni një ekip dhe filloni realizimin e projekt ideve menjëherë.**

### **DITA 3 – SFIDA E IDEVE TUAJA TË REJA**

**Me ekipin tuaj të ri, ju do të vendosni të testoni idetë tuaja menjëherë, për shembull duke organizuar fushatën e parë të shkurtër dhe spontane, duke intervistuar kalimtarët ose duke u takuar me partnerë të mundshëm.**

### **DITA 4 – BËNI QË PROJEKTI JUAJ TË MARR KRAHË**

**Merrni reagimet nga ekspertët dhe finalizoni projektin tuaj. Në pasdite, ju do të lançoni këtë projekt përballë një jurie që do t'ju këshillojë se si të vazhdoni pas përfundimit të imp!act Tirana - në qoftë se ju dëshironi ta realizoni. Më në fund, është koha për të festuar të gjitha arritjet tuaja!**

## Imagjoni, Ju mund të përqafoni ndryshimin nëpërmjet dizenjimit të projektit TUAJ!

Ende nuk jeni bindur? **3** arsyt kryesore për të marrë pjesë:

- ✓ Përkrahje dhe mjete për të kthyer idetë tuaja në veprim: Praktikimi i aftësive profesionale dhe personale që do t'ju shërbejnë gjatë gjithë jetës. Do të mësoni se si të merrni vëmendjen e audiencës për të prezantuar një ide, se si të menaxhoni një projekt që nga faza e idesë deri në implementimin e tij, si të bindni të tjerët për t'iu bashkuar projektit tuaj, etj.
- ✓ Njohje me ekspertë në fusha të ndryshme, nga biznesi, ndërmarrjet sociale dhe organizatat jo qeveritare. Do të bëheni pjesë e një komuniteti të motivuar që do t'ju sjellë një rrjet të gjërë kontaktesh.
- ✓ Së fundmi, nuk duhet nënvlerësuar energjia pozitive që aktivizohet sa herë që ndjekim një pasion apo thjesht përdorim kreativitetin për ti bërë gjërat të lëvizin. Ju do të punoni shumë, por - ju premtojmë - do të këtë mjaftueshëm kohë edhe për argëtim!

## APLIKO TANI!

**Ndani me ne arsyet pse dëshironi të aplikoni apo nqs keni tashmë një projekt ide.**

**Trajnimi do të mbahet në gjuhën shqipe dhe është i hapur për të rinjtë e kryeqytetit nga mosha 16 deri në 30 +.**

**Materialet e punës, transporti urban, ushqimi, pushimi i kafesë etj. do të jenë të mbuluara nga organizata DEV-AID.**

**Të rinjtë që do të ndjekin të plot trajnimin do të pajisen me një certifikatë pjesëmarrje.**

**Tarifa e pjesëmarrjes është 1000 lekë.**

***SUKSESE!***

